



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 Nr.60/01-31158/24
Kaçanik 11.12.2024

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Komunitete, me datën 17.12.2024 (e Martë), do të mbahet mbledhja e X (dhjetë) e rregullt e Komitetit për Komunitete, për vitin 2024. Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës në sallën e Komiteteve, më fillim pune në ora 13:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq, Ekrem Livoreka, Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Në mbledhjen e X (dhjetë) të Komitetit për Komunitete, të datës 17.12.2024, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

- 1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete ;
- 2.OVL UÇK-së në komunën e Kaçanikut;
- 3.Të ndryshme.

Ju mirëpresim,

Me respekt!

Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01-29344/24
Kaçanik, 27.11.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **IX (nëntë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 27 nëntor 2024 (e Mërkurë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 13:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri - Çaka - PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK. Mungoj Arben Thaqi - OJQ

Nga Ekzekutivi i komunës në takim mori pjesë Pranvera Loku Zharku – Drejtoreshë DZHET në komunën e Kaçanikut.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e IX -të (nëntë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2024, data 27 nëntor, me këtë :

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. Gjendja e bizneseve në komunën e Kaçanikut; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete.

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesuesi i Komitetit, Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së kaluar? Nëse jo, a jeni dakord për miratimin e tij?

Procesverbali i mbledhjes së VIII (tetë) të Komitetit për Komunitete për vitin 2024 u miratua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete e,

Aprovoj
Procesverbalin e mbledhjes se VIII (tetë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2024,
të datës 29.10.2024 / Lënda : 01Nr. 60/01-27104/24.

2. Gjendja bizneseve në komunën e Kaçanikut:

znj. Pranvera Loku Zharku: Në funksion të biznesit lokal ekziston Qendra Komunale për Regjistrimin e Bizneseve. Përmes kësaj qendre komuniteti i biznesit për një periudhë të shkurtër mund të regjistrojnë apo themelojnë veprimtarinë biznesore. Po ashtu përmes saj bëhet edhe ofrimi i informatave për investitorët potencial, gjithashtu jepen këshilla ndaj bizneseve fillestare dhe atyre ekzistuese në plotësimin e aplikacioneve të ndryshme sipas nevojës, me qëllim të qasjes më të lehtë në financa apo mjete fikse që mund të përfitojnë nga donatorët e ndryshëm.

Nga të dhënat që posedon Qendra komunale për regjistrimin e biznesit deri në tetor të vitit 2023, ushtrojnë aktivitete biznesore gjithsej 1600 ndërmarrje. Nga bizneset e regjistruara 75% janë Biznese Individuale ndërsa 23% biznese Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe pjesa tjetër përfshin Shoqëritë Aksionare - Ortakëritë, Bizneset e huaja dega në Kosovë etj.

Ndërmarrjet të cilat kanë pronar të gjinisë femërore janë 17% (tipi biznesit tek pronaret femra fokusohet më shumë në biznese individuale). Ndërsa pronaret meshkuj përfshin rreth 83% të bizneseve. Viteve të fundit ka rritje të bizneseve të tipit Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.

Sektorët ekonomik dominues janë kryesisht tregtia me shumicë dhe pakicë, aktivitetet shërbyese dhe ndërtimtaria. Tregtia përfshinë 31% të ndërmarrjeve, aktivitetet shërbyese 27%, ndërtimtaria 11%, ndërsa 31% përfshihen sektorët tjerë. Këta sektorë janë shquar për rritje gjatë viteve të fundit, ndërsa rënie nuk është shënuar në asnjë sektor. Përkundër potencialeve të Kaçanikut për zhvillimin e bujqësisë, ky sektor mbetet fare pak i përfaqësuar, me vetëm 4%.

Dominimi i sektorit privat është një tregues i ndërmarrësisë në nivel komunal, i cili ka nevojë për përkrahje të mëtejme, duke pasur parasysh edhe potencialet lokale.

Numri më i madh i ndërmarrjeve është i përqendruar në Kaçanik, si qendër komunale zonën urbane janë të koncentruar 49% të numrit të ndërmarrjeve në nivel komunal.

Vendbanimi i dytë për nga numri i ndërmarrjeve është fshati Doganaj 6%, e pasuar nga Kaçaniku i Vjetër, Dubrava etj. Gjatë viteve të fundit, përgjithësisht numri i ndërmarrjeve në të gjitha vendbanimet është rritur, përveç në disa fshatra të vogla ku numri ka mbetur konstant.

Statistikat nga regjistrimi i bizneseve të grupuara sipas llojit të bizneseve.

Gjithsej biznese të regjistruara nga 01/01/2024-31/10/2024 janë 122

SH.P.K, janë regjistruar 88 biznese, B.I. janë regjistruar 34 biznese

Gjithsej biznese të regjistruara nga 01/01/2023-31/10/2023 janë 134

SH.P.K. prej 01/01/2023-31/10/2023 janë regjistruar 86 biznese, B.I. prej 01/01/2023-31/10/2023 janë regjistruar 48 biznese

Diferenca përgjatë vitit 2024 ka 12 Biznese të regjistruara më pak se në vitin 2023

Shuarje të biznesit - 9 biznese.

10 Aktivitete që shërbejnë më së shumti nga bizneset në vitin 2024 deri me 31 tetor:

Aktivitet shërbyese të pijeve - 17 biznese;

Tregtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike të vogël - 12 biznese;

Aktivitetet e tjera shërbyese të ushqimit - 12 biznese;
 Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore - 12 biznese;
 Punime suvatimi - 11 biznese;
 Punime për veshjen e dysheve dhe mureve - 11 biznese;
 Tregtia me shumice e mobileve, pajisjeve të ndriçimit, dyqaneve - 11 biznese;
 Aktivitetet e tjera të specializuara të ndërtimit p.k.t. - 10 biznese;
 Tregtia me shumice jo e specializuar – 9 biznese;
 Prodhimi i mobileve të zyrave dhe dyqaneve – 9 biznese.
 Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm (DZHET) në Komunën e Kaçanikut, në bazë të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve në Komunën e Kaçanikut, në kuadër të Programit "Subvencionimi i bizneseve ekzistuese mikro dhe të vogla" këtë vit ka subvencionuar 15 biznese. Fondi 56.000.00€ dhe shpenzimet afër 30.000.00€.
 Qëllimi i Programit "Subvencionimi i bizneseve ekzistuese mikro dhe të vogla", ka për synim fuqizimin ekonomik të bizneseve lokale, përkatësisht promovimin dhe rritjen e tyre. Thirrja ka pasur qëllim të mbështetë zgjerimin e bizneseve për punësim kryesisht të grave dhe të rinjëve.

znj. Lejla Çaka: Çfarë mbështetjeje ofrojnë këto subvencione për bizneset e vogla?

znj. Pranvera Loku Zharku: Subvencionet për mjete punë janë realizuar me një bashkëfinancim prej 70% nga komuna dhe 30% nga bizneset. Shuma maksimale e subvencionuar nga komuna ka qenë 2.100.00€, ndërsa vlera totale e grantit ka arritur deri në 3.000.00€.

znj. Arta Avdiu: Drejtoreshë, ju th'atë se subvencionet kanë qenë 56.000.00€. Siç di unë, deri në thirrjen e parë janë ndarë 20.000.00€, a do të ketë ndonjë thirrje tjetër?

znj. Pranvera Loku Zharku: Jo, ka qenë afërsisht 30.000.00€.

znj. Arta Avdiu: Siç di unë, në shpallje ka qenë 20.000.00€ që janë ndarë për thirrjen e parë. Tani ka mbetur kjo pjesa tjetër, ku menaxhohen këto mjete?

znj. Pranvera Loku Zharku: Në këtë thirrje kemi pasur rreth 15 përfitues, dhe përafërsisht 30.000.00€ janë shpenzuar.

znj. Arta Avdiu: 20.000.00€ janë ndarë për këta 15 përfitues. A nuk mund të ketë një thirrje të dytë, pasi ka mbetur një pjesë e madhe e mjeteve?

znj. Pranvera Loku Zharku: Jo, nuk do të ketë thirrje të dytë. Fondi që ka mbetur në dispozicion, pra 27.000.00€, do të transferohet për vitin tjetër, pasi janë të ardhura vetanake. Do të ketë një thirrje vitin tjetër dhe fondi do të jetë pak më i madh, sepse këto mjete do të bartën dhe do të mbështesin dy kategori.

znj. Arta Avdiu: Besoj se vitin tjetër do të keni buxhet. Mendoj se vitin tjetër duhet të kemi dy ose tri thirrje, ashtu siç po bëjnë drejtoritë e tjera, për t'u dhënë mundësi të aplikojnë edhe bizneseve të tjera, jo vetëm 15 bizneseve që përfituan deri tani. Po kemi dyshime se ku po shkojnë paratë?

znj. Pranvera Loku Zharku: Paratë bartën për vitin e ardhshëm, pasi janë të hyra vetanake, dhe do të transferohen në fondin e subvencioneve të drejtorisë përkatëse.

znj. Arta Avdiu: Kam një vërejtje për kriteret. i kam parë ato dhe më duken të ulëta, kryesisht subvencionet janë për të ndihmuar bizneset e vogla. Dua të di se kush i vendos këto kriterë, pasi nuk mund të ketë të ardhura mujore mbi 2.000.00€, kur e dimë që shumica e bizneseve të vogla nuk kanë qarkullim.

znj. Pranvera Loku Zharku: Qarkullimi prej 2.000.00€ është minimal për një biznes funksional, pasi një biznes funksional duhet të ketë një qarkullim vjetor. Ne thjesht kemi kërkuar që këto biznese të deshmojnë se janë aktive. Po thuajse të gjithë dokumentet janë nxjerrë në Komune, ndërsa vërtetimet nga ATK-ja mund të merren online. Ndoshta kjo ka qenë arsyeja pse nuk kanë aplikuar pasi që ne dukje ka pasur një mori dokumentesh që kërkoreshin por të gjitha janë nxjerrë në komune nuk mendoj që ka qenë qarkullimi vjetor arsyeja. Qarkullimi vjetor prej 2000 euro për bizneset funksionale është minimal po ta llogaritesh me ditët e punës.

z. Ekrem Livoreka: Drejtoreshë, kam një pyetje për 9 bizneset që janë mbyllur. A ka ndonjë arsye për këtë, si mungesa e fuqisë punëtore, apo janë mbyllur për ndonjë arsye tjetër?

znj. Pranvera Loku Zharku: Jo, nuk ka qenë mungesa e fuqisë punëtore. Zakonisht, numri i bizneseve që mbyllet në vit është mes 9 deri 14. Nuk mund të them se kjo është arsyeja, pasi ka pasur biznese që janë mbyllur edhe më herët për arsye të ndryshme. Nuk është shqetësuese, sepse vitin e kaluar janë mbyllur gjithsej 12 biznese në periudhën e njëjte kohore.

znj. Arta Avdiu: Edhe një pyetje për përqindjen që përmendët për bujqësinë, 4%. A keni ofruar ndonjë përkrahje këtyre bizneseve apo ndonjë subvencion më të lartë për t'i motivuar që të merren me bujqësi dhe të rritet kjo përqindje, edhe pse pak?

znj. Pranvera Loku Zharku: Këtë vit ka pasur shumë subvencione për bizneset dhe fermerët, përfshirë mekanizmat bujqësorë si frezat, multikultivatorët dhe shumë të tjera. Nuk jam kompetente për të folur për bizneset në bujqësi, pasi me këtë fushë merret kryesisht nga Drejtoria e Bujqësisë. Megjithatë, edhe bizneset e vogla dhe familjare, që janë të pranishme, nuk janë shumë të mëdha, përveç disa që ndodhen në fshatin Koxhaj, si serat, ndërsa shumica e të tjerave merrem me blegtori. Po ashtu, ato që merren me pemëtarë dhe blegtori konsiderohen biznese bujqësore.

znj. Arta Avdiu: Shpresojmë që vitin tjetër të kemi një rritje më të madhe të përqindjes se 4%, sepse kjo ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të qytetit.

znj. Pranvera Loku Zharku: Në përgjithësi, fermerët kanë përfituar shumë nga donacionet, dhe Drejtoria e Bujqësisë nuk është ndaluar duke dhënë subvencione.

z. Ekrem Livoreka: Është e vërtetë që subvencionet në bujqësi këtë vit kanë qenë të mëdha, dhe shoqata Islamic Relief ka ndihmuar shumë në subvencionimin e komunës së Kaçanikut.

znj.Arta Avdiu: Po ashtu, në lidhje me gratë, 17% e bizneseve individuale zakonisht janë drejtuar nga femra. A përfaqësohet ndonjë biznes i madh nga gratë, apo janë vetëm bizneset e vogla dhe të mesme?

znj. Pranvera Loku Zharku: Shumica e bizneseve janë të vogla dhe të mesme; nuk ka që biznese të mëdha drejtuar nga gratë. Kryesisht, natyra e bizneseve këtu është te vogla e te mesme, pasi nuk kemi shumë ndërmarrje të mëdha, përveç Silkaporit dhe Kivose të ngjashme. Ndërsa bizneset që menaxhohen nga gratë përfshijnë kryesisht sallonet e ondulimit, butiqet, rrobaqepësit dhe artizanatet marketet e vogla e kështu të ngjashme.

z. Ekrem Livoreka: A kanë bizneset e reja, që janë start-up, tatimin e njëjtë me ato që kanë një kohëzgjatje më të gjatë, apo a ndryshon kjo? Po ashtu, a ka ndonjë dallim në mënyrën e tatimit mes bizneseve që udhëhiqen nga gratë dhe ato që udhëhiqen nga meshkujt?

znj. Pranvera Loku Zharku: Sa i përket taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë, komuna e Kaçanikut ka hequr këtë taksë që nga koha e pandemisë. Po ashtu, për disa lloje biznesesh prodhuese dhe përpunuese, taksa ishte hequr më herët. Gjatë pandemisë, komuna ka liruar të gjitha bizneset nga taksa komunale. Ndërsa për taksën shtetërore, është kompetente Administrata Tatimore e Kosovës, prandaj nuk kam informacione të detajuara lidhur me këtë çështje. Bizneset që udhëhiqen nga gratë nuk përfitojnë ndonjë lehtësirë specifike në lidhje me tatimet, por sa i përket granteve që jepen nga ministrit e ndryshme, ka lehtësira më shumë për gjinën femërore.

znj.Arta Avdiu: Për mua, shqetësuese është fakti që mjetet për subvencione janë bartur, por nuk janë shpenzuar këtë vit. Meqenëse ato janë ende në dispozicion këtë vit, pse nuk bëhet edhe një thirrje tjetër për t'i ndihmuar edhe bizneseve të tjera, dhe jo vetëm 15 bizneseve që kanë përfituar?

znj. Pranvera Loku Zharku: Thirrja ka qenë publike dhe askush nuk ka ndaluar aplikimin. Fondi ka qenë në dispozicion dhe mund të shfrytëzohej nga kushdo që aplikonte.

z. Ekrem Livoreka: Drejtoreshë, këto 15 biznese që kanë aplikuar kanë përfituar, ndërsa të tjerët jo?

znj. Pranvera Loku Zharku: Po, 15 biznese kanë përfituar, ndërsa dy prej tyre janë refuzuar për shkak se veprimtaria e tyre biznesore nuk ka plotësuar kriteret. Atëherë pjesë në kriteret jo kualifikuese pra aktiviteti i tyre ishte ndërtimtaria, që nuk ishte një fushë që subvencionohej sipas thirrjes.

znj. Arta Avdiu: Nuk po them që fondi duhet domosdoshmërisht të shkojë për subvencione, por mund të shfrytëzohet diku tjetër. Po e thatë që mund të bartet, dhe nëse lejohet që të bartet, pse të mos shfrytëzohet këtë vit?

znj. Pranvera Loku Zharku: Nuk kemi bërë dy thirrje publike, por ka mundësi që ato mjete të shpenzohen për diçka tjetër. Ato mund të destinohen për mbështetje në bashkëfinancim me ndonjë donatorë që të mbështet bizneset ose për ndihma të tjera. Ky

ka qenë qëllimi i mos insistimit për dy thirrje publike se fondi ka qenë I vogël për të pasur një thirrje të dytë.

P.sh Në vitin e kaluar, fondi që ka mbetur në dispozicion është shfrytëzuar për një marrëveshje që kemi bërë si komunë me një program të Bankes Botërore dhe Ambasaden Japoneze. Komuna ka mbështetur një program “Komuna për të rinjtë”, dhe ne kemi bashkëfinancuar. Ky program kishte për qëllim mbështetjen e të rinjve, grave dhe grupeve të marginalizuara të tjera.

3. Të ndryshme:

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën e ndryshme? Nëse jo, atëherë shpall mbledhjen të mbyllur në ora 14:34.

**Procesmbajtësja
Mavije Murseli**

**Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka**